



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.58/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania “Exclusive” SH.P.K me seli Gjilan, me adresë Rruga Qarkore p.n, me NRB 70479274, përfaqësuar sipas autorizimit nga F.Q. avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë. Adresa: Rr. “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lublanës, Kati i V-të, dhe të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë, Rr. “Zagrebi” p.n. Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018 pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë në seancë publike me datë 05.09.2023 me pjesëmarrje të përfaqësuesve të të gjitha palëve, dhe datë 06.03.2024 me pjesëmarrje përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, përfaqësueses së autorizuar të OSHP E.P., në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së dytë, më datë 25.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Kompania “Exclusive” SH.P.K me seli Gjilan, me NRB 70479274, kundër të paditurës së parë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e Vendimit PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018, **si e pabazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 19.04.2018, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Kompania Exclusive SH.P.K me seli Gjilan, me adresë Rruga Qarkore p.n, me NRB 70479274, i përfaqësuar sipas autorizimit nga F.Q. avokat me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi (e evidentuar me numrin A.847/18) kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë me kërkesë padi për anulimi të Vendimit PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018, me propozim që të aprovohet kërkesë pada si e bazuar, të anulohet vendimi i kundërshtuar dhe sipas precizimit të kërkesëpadisë me datë 11.03.2024 të obligohet e paditura e dyta ti paguaj kompensimin për dëmin e shkaktuar me vendim të kundërligjshëm në shumë prej 1,201,974.42 €, brenda 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 58/22.
3. Më datë 27.07.2023 gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor, ndërsa seanca e shqyrtimit kryesorë u mbajt me datë 05.09.2023 me pjesëmarrje të përfaqësuesit së autorizuar të paditësit F.Q. avokat, përfaqësueses së autorizuar të paditurës së parë OSHP-së E.P. dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar nga Avokatura Shtetërore A.Z., ndërsa seanca e datës 06.03.2024 u mbajt me pjesëmarrje të përfaqësuesit së autorizuar të paditësit F.Q. avokat, përfaqësueses së autorizuar të paditurës së parë OSHP-së E.P., me pjesëmarrje të ekspertes A.Q.B. dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar nga Avokatura Shtetërore (konform nenit 41 të LKA-së).

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në deklaratimet e dhëna në seancë dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Departamenti Administrativ A.nr.1323/2012 është aprovuar kërkesë padia e paditësit kundër vendimit të OSHP-së të vitit 2012, dhe çështja është kthyer të paditurës në rivendosje. Me aktvendimin e kundërshtuar tani të goditur me këtë padi është vendosur përsëri në dëm

të paditësit dhe atë kryesisht duke u bazuar në çështjen e anulimit të autorizim marketingut për barnat e importuara nga Serbia. Deklaron se anulim i autorizim marketingut për prodhuesin ka ndodhur pas përfundimit të tenderit që është objekt i këtij kontesti andaj me vendimin e ri të OSHP-së vendimi bazohet në provën e krijuar më vonë e për të cilën gjatë kohës së tenderit palët nuk kanë qenë në dijeni për ndryshime. Ministria e Shëndetësisë në kontratën kornizë për 24 muaj shprehimisht e ka obliguar paditësin që produktet e furnizimit duhet të jenë nga prodhuesi Zdravie për të cilën më vonë është ka konstatuar se nuk ka autorizim marketing të vlefshëm, e që këtë fakt ministria është dashur ta dijë qysh atëherë për shkak se certifikatat për eksportin e barnave dhe materialeve medicinale Serbia i jep me destinacion për shtetin ku ato eksportohen dhe në këtë rast kjo nuk ka qenë e mundur për shkak mos njohjes së Kosovës, Gjykatës ia ka dorëzuar si provë kontratën që e përmendur ku në faqen 2 është e shënuar dispozita përmes së cilës ministria e ka obliguar paditësin që produktet duhet të jenë ekskluzivisht nga Zdravie.

5. Ka deklaruar se paditësi është dëmtuar nga vendimet e paligjshme të paditurave, e paditura e dyte Ministria e Shëndetësisë edhe pse është dashur ta dije se produktet farmaceutike serbe nuk e kanë certifikatën autentike të eksportit për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga Serbia, ato me kontrate e kanë detyruar paditësen që të importoj pikërisht produktet e prodhuesit Zdravije nga Serbia. Për më tepër, e paditura e dyte, pavarësisht se e ka ndaluar me vone importimin e produkteve të Zdravljës, anjeherë nuk ka nxjerre një vendim lidhur me këtë ndalesë dhe me këtë ia ka pamundësuar paditëses që t'ia kthejë mallrat e importuara prodhuesit me seli në Serbi.
6. Kundërshtimi i të paditurës së dyte ndaj kërkesëpadisë së paditëses se kërkesa e paditëses është e parashkruar. Në rast se baza juridike e kërkesës do të ishte dem i shkaktuar, parashkrimi do të duhej llogaritur nga momenti kur paditësi e ka kuptuar se i ka ndodhur dem dhe dem i ka ndodhur në momentin kur është marrë aktvendimi i paligjshëm. Meqenëse pala në procedurën administrative ka afat prej 30 ditësh për parashtrimin e padisë për fillimin e konfliktit administrativ ndaj vendimit të paligjshëm, kurse afati i parashkrimit të kërkesave për kompensimin e demit është 3 vite, është e qarte se kërkesa e paditësit nuk ka mundur të parashkruhet. Deklaron se sipas LMD, dem konsiderohet çdo zvogëlim i pasurisë si rezultat i veprimit të kundërligjshëm.
7. Në rast se baza juridike e kërkesës për dëmshpërblim do të konsiderohej marrëdhënia kontraktuese ndërmjet palave, atëherë do të duhej zbatuar neni 110 i LMD të vitit 1974,

i cili përcakton se kërkesat nga kontratat nule nuk parashkruhen. Pa dyshim që kontrata mbi baze të së cilës është bërë furnizimi me produkte medicinale nga Zdravlje është nule, ngase Zaravije e ka mashtruar paditësen se kinse është në posedim të Certifikatave të produkteve, pa të cilat mallrat nuk do të mund të eksportoheshin në Kosovë. Është konstatuar me vone Certifikatat e prezantuar nga e paditura e parë kanë qene jo autentike, ngase Serbia nuk lëshonte certifikata të tilla për export në Kosovë, për shkak të mosnjohjes. Paditësja nuk ka pasur se si ta dije që certifikatat nuk janë autentike, por të dy të paditurat kanë qene në dijeni, ose është dashur ta dinin pikërisht për shkak të autorizimeve publike që i kanë si organe apo agjenci ekzekutive të shtetit.

8. Lidhur me pretendimin e të paditurës së dyte se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, deklaron se as ky pretendim nuk qëndron, ngase në çështjen kontestimore, të cilës i referohet e paditura e dyte dhe e cila tani është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ngase baza juridike e çështjes kontestimore të padisë është demit kontraktues, palët nuk janë të njëjta, e paditur e parë është "Zdravlje" nga Serbia, e cila edhe ka paraqitur dokumentacionin jo autentik përmes të cilit paditësi ka importuar materiale medicinale sipas detyrimit që e kishte nga Ministria e Shëndetësisë. Kurse në këtë procedurë të konfliktit administrativ çështje e shqyrtimit është paligjshmëria e vendimit administrative.
9. Paditësi e konsideron të paligjshëm vendimin e të paditurës së parë PSH.nr. 271/2012, të datës 20.03.2018, ngase ai vendim nuk e merr parasysh një veprim dëmtues të paditurës së dyte, e cila me kontratë e ka detyruar paditësin që të importoj mallra të cilat pastaj i ka përjashtuar nga qarkullimi juridik. Meqenëse kjo çështje është gjykuar një herë në Gjykatën Themelore Departamenti Administrative me të aktgjykim çështja ishte kthyer në rivendosje, kurse OSHP ka marrë vendim, kërkon nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia të vërtetohet paligjshmëria e vendimit, kurse me dëmshpërblim të ngarkohet e paditura e dytë.

#### Kundërshtimet e të paditurës së parë - OSHP

10. Përfaqësuesi i të paditurës së parë OSHP-së, në përgjigje në padi gjatë deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë vendimit të panelit Shqyrtues i nxjerrë në rivendosje, sipas të cilit vendim

është konstatuar pothuajse e njëjta gjendje si në vendim paraprak për shkak se kjo është një lëndë e viti 2012 ndërsa në vitin 2018 kur është kthyer lënda në rivendosje të gjitha procedurat kanë mbaruar situatë kjo e krijuar jo nga OSHP. I propozon gjykatës që pas administrimit dhe vlerësimit të provave ta refuzoj padinë si të pa bazuar për shkak se operatori ekonomik tani paditësi nuk ka ofertuar sipas dosjes së tenderit më saktësisht nuk ka ofruar autorizimi marketingun për qarkullimin e produkteve medicinale të prodhuesve nga Serbia, sipas legjislacionit në fuqi AKPM-së, për këtë arsye paneli shqyrtues i OSHP-së ka refuzuar kërkesën e operatorit. Sqaron se në kohën kur është zhvilluar procedura në Gjykatën Themelore sipas kërkesës së gjyqtarit të çështjes OSHP ka kërkuar nga MSH që të sjellë ofertat dhe dosjen e tenderit pasi që këto nuk i ka në posedim OSHP por autoriteti kontraktues nuk janë përgjigjur kërkesës së OSHP-së. Andaj ka propozuar që gjykata do të kërkojë nga MSH që të sjellë ofertën e paditës dhe dosjen e tenderit.

11. E paditura e pare sqaron se pretendimet ankimore te operatorit ekonomik ankues janë te paqëndrueshme Vendimi kontestues Psh. nr. 271/2012 te dates 20.03.2018 është i ligjshëm ngase produktet e paditësit nuk kane mundur te plasohen ne treg për shkak se Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale ka pezulluar Certifikatën e Autorizim Marketingut me qellim te mbrojtjes së shëndetit publik, për shkak te dilemave që jane paraqitur ne lidhje produktet e prodhuesit te cilin paditësi ka përfaqësuar ne këtë aktivitet te prokurimit.
12. Sipas Ligjit Nr.03/L-188 Për Produkte dhe Pajisje Medicinale i cili ishte ne fuqi ne kohën kur ishte nxjerr vendimi mbi pezullim te Autorizim Marketingut parashihej se: "Autorizimi për Marketing është sinonim (ka kuptim te njejtë) me licencën e produktit medicinal dhe produktit medicinal i autorizuar për te siguruar dokumentacionin, si dhe dëshmi fizike se cilësia, siguria dhe efikasiteti i produktit medicinal i plasuar ne Republikën e Kosovës, përmbush standardet e përcaktuara ne akt nënligjor te nxjerre ne pajtim me këtë ligj. Bazuar ne këtë Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për të mos blere produkte te tilla siguria e te cilave ishte e diskutueshme, është vendim i drejte dhe i ligjshem.

13. OE ankues, tani këtu paditësi, nuk ka arritur te dëshmoj interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit te zbatuar nga autoriteti kontraktues MSh ne pajtim me nenin 4 par. 1 pika 26 te LPP-Se, ne te cilin thuhet se: 1.26. Palë e interesuar - personi që mund te dëshmoje interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit te zbatuar nga autoriteti kontraktues ne raport me një kontrate te veçante publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qene ose mund të jete ne rrezik te dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.
14. Paneli shqyrtues duke pasur parasysh te gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë qe janë prezantuar nga palët ne procedure, këtë vendim e mbështet në nenin 104 paragrafi 4 te LPP-së, pasi qe ka marr për baze pasojat e mundshme të dëmtimit te interesit publik-dëmtimit te buxhetit sepse ne këtë aktivitet te prokurimit, ngase neni 1 i LPP-se qartëson ne mënyrë eksplicite, se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, më transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike. I propozon Gjykatës që pas administrimit të provave ta refuzoje padinë e paditësit si te pabazuar dhe ta leje ne fuqi vendimin e te paditurës OSHP Psh.nr. 271/2012 i datës 20. 03. 2018 te atakuar nga paditësi. E kundërshton në tërësi ekspertizën financiare të datës 14 shkurt 2024 te ekspertes A.B. si ne tërësi te paqëndrueshme si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia sepse ne rastin konkret nuk kemi te bëjmë me dëm te shkaktuar dhe supozimet për fitimin e humbur janë te paqëndrueshme.

#### Kundërshtimet e të paditurës së dytë MSH-së

15. Përfaqësuesi i autorizuar nga avokatura shtetërorë për të paditurën e dytë Ministrinë e Shëndetësisë si autoritet kontraktues, në përgjigje në padi gjatë deklarimeve në seancë të shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka Ministria e Shëndetësisë e Republikës se Kosovës e konteston ne tërësi kërkesëpadinë e Paditësit Kompanise Exclusive ShPK dhe i propozon Gjykatës që ta refuzoj si tërësisht te pabazuar për shkak se oferta e kompanisë ishte e papërgjegjshme sipas Ligjit te Prokurimit Publik dhe kërkesave te dosjes se tenderit.
16. Sipas Ligjit Nr. 03/L-188 për Produkte dhe Pajise Medicinale i cili ishte në fuqi ne Kohen kur ishte nxjerr vendimi mbi pezullim te Autorizim Marketingut ai definohej si

"Autorizim për Marketing" është sinonim (a kuptim te njëjte) me licencën e produktit medicinal për te siguruar dokumentacionin, si dhe dëshminë fizike se cilësia, siguria dhe efikasiteti i produktit medicinal i plasuar në Republikën e Kosovës, përmbush standardet e përcaktuara në afatin nënligjor te nxjerre ne pajtim me kete ligj." Andaj edhe vendimi i Ministrise se Shendetesise per te mos blere produkte te tilla siguria e te cilave ishte e diskutueshme, ishte vendim i drejte dhe i ligjshëm.

17. Çështja e kompensimit të dëmit në lidhe me këtë vendim për pezullimin e Autorizim Marketingut tanimë është gjykuar, pasi qe Paditësi i eshte refuzuar padia kundër Qeverise se Republikës se Kosovës - Ministrisë se Shëndetësisë dhe Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale ne rastin III. Ek. nr. 489/2017 e ky vendim është vërtetuar nga Gjykata Supreme Aktgjykimi nr. III.Ek.nr.489/2017; III.EK.31/2021, K.DH.SH.nr.802/22 dhe Aktvendimi E.Rev.nr.1/2023) Prandaj çështja e kompensimit të dëmit është çështje e gjykuar. I propozon gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit Kompania Exclusive me seli ne Gjilan, ne teresi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i te paditurës PSH.nr.271/2012, i datës 20.03.2018.

#### Provat e administruara

18. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aktgjykimi A.nr.1323/2012 nga Gjykatës Themelore Prishtinë, Vendimi i OSHP-së nr. 271/2012 me datë 20.03.2018, MEMO e AKPPM-së, Kontrata me nr. reference 71300/10/647/111 për furnizim me barna dhe material shpenzues ndërmjet MSH dhe Kontraktuesi Exklusiv SH.P.K, sipas kësaj kontrate respektivisht neni 2 thuhet se produktet duhet jenë nga prodhuesi Zdravlje, Actavis , Company- Serbi, konform ofertës financiare të kontraktuesi të datës 20.10.2010 me pamundësi të ndryshimit, kontrata e vlefshme me afat prej 24 muajsh, Oferta e operatorit Ekonomik, Aktgjykimi me nr III EK 489/2018 të datës 30.09.2019, Aktvendimi i Gjykatë Supreme E.REV. nr.1/2023, Dosja e prokurimit e dorëzuar në gjykatë me datë 28.08.2023, ku si pjesë e dosjes së tenderit janë vendimi i dorëzuar përmes E-mail me datë 19.01.2012, Njoftimi me datë 17 gusht 2012 drejtuar kompanisë Exclusive, Raport i ekspertit

shqyrtues i dorëzuar me datë 28.09.2012, akt përcjellës analiza lidhur me ankesën 271/12 të OE Exclusive SH.P.K Gjilan me datë 28.09.2012, Njoftimi për dhënie të kontratës me datë 05.09.2012, i është bashkangjitur dosja e tenderit, Raporti i vlerësimit të tenderëve. Ankesë nga Exclusive SH.P.K Gjilan për OSHP-në me datë 14.09.2012 bashkangjitur certifikate e autorizimit të marketingut, Certifikate me nr MA 0417/121208, MA 04-20/12058, MA 1313/51208 të gjitha janë të lëshuar 15.08.2008 me datë të skadencës 12.12.2013, Marrëveshje e datës 20 janar 2012 në mes Aktavis Internacional Limite dhe Exclusive SH.P.K, Lista e vlerësimit të standardeve të përshtatshmërisë, Kontrata Publike me OE LIRI MED për të njëjtin aktivitet të prokurimit, Ekspertiza e përgaditur nga ekspertja A.Q.B. më datës 14.02.2024.

### Baza Ligjore

#### 19. LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1 paragrafi 1 përcakton se *“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla, Neni 6 përcakton Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1 parasheh se “të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit” neni 7 përcakton , Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminim, paragrafi 1 specifikon se: “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente” Neni 59 përcakton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, paragrafi 2 përcakton “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë*



*që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”, paragrafi 3 përcakton “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla”, paragrafi 4 “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”, ”Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.*

#### Vlerësimi i gjykatës

20. Fillimisht Gjykata e vlerëson të pabazuar pretendimin e te paditurës se dyte se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, sepse konstaton se me Aktgjykim III.Ek.489/2017 të datës 30.09.2019 dhe Aktgjykim III.EK.nr.31/2021, përkundër që e paditur është MSH, baza e kërkesëpadisë është kompensim dëmi të pretenduar për shkak të pezullimit të certifikatave të marketing autorizimit nga MSH, ndersa në këtë procedure të konfliktit administrativ baza e padisë është shqyrtimit i ligjshmëris së vendimit administrativ PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018 dhe komensimi i demit të shkaktuar me këtë vendim.

21. Prandaj vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve të palëve në seance dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar.
22. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale, përmes emailës së datës 19.01.2012 i ka njoftuar OE, në mesin e tyre edhe paditësi Exkluzive sh.p.k. për vendimin e Ministrisë të Shëndetësisë për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia.
23. AK MSH me datë 06.08.2012 ka shpallur publikimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111. Sipas dosjes se tenderit në specifikimet teknike, në seksionin 9.1 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika dy: kërkohet që barnat duhet të kenë Certifikatën për Marketing për Kosovë (5 vjeqare). Me datë 17.08.2012 AK Ministria e Shëndetësisë përmes emailit i ka njoftuar, ju ka derguar sqarim secilit OE, përfshirë paditësin se të gjithë operatorët ekonomik të interesuar të cilët kanë tërhequr dosjet e tenderit, informohen se nuk mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik të cilët ofertojnë me produktet medicinale të prodhuesve nga Serbia si: "Zdravle Aktavis" - Leskovc, "Hemofarmi - Stada" - Vrshac dhe "Jugoremida" - Zrenjanin. Ndrësa në kërkesë për sqarim përmes emaili-it datë 22.08.2012 nga MSH, janë njoftuar se produktet që ndodhen në treg dhe që janë të importuara dhe posedojnë banderolën, kanë të drejtë shitje në sistemin farmaceutik dhe nuk ka sanksion për pjesëmarrje për furnizime në sektorin publik. Afati për Dorëzim të ofertave ishte deri me datë 27.08.2012. Hapja e ofertave është bërë me datën 27.08.2012, ku kanë ofertuar dhjetë (10) operator ekonomik. AK MSH me datë 05.11.2012, ka publikuar në ueb faqen e KRPP-së njoftimin për dhënie të kontratës për lotët 1, 2, 3 dhe 5. Me datë 14.09.2012, Operatori Ekonomik "Exklusiv" shpk, nga Gjilani, ka parashtruar ankese në OSHP, me pretendimet ankimore se nuk janë respektuar dispozitat e LPP-se dhe atë nenet: 6, 7, 54, 56, 59, 60 dhe 64, të LPP-se. Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjegjësisht

Paneli Shqyrtues me datën. 08.10.2012, me r. 271/12, nxjerr Vendim dhe ka refuzuar ankesën e OE "Exklusiv" shpk, nga Gjilani, me arsyetim se AK- MSH, ka zbatuar vendimin ne fuqi te Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale (AKPM) dhe te MSH-se mbi pezullimin e importit te produkteve medicinave nga Serbia, derisa te behet verifikimi i kualitetit te tyre. Po ashtu Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK- MSH, gjate fazës se tenderimit i ka njoftuar te gjithë operatoret ekonomik të interesuar te cilët kane tërhequr dosjet e tenderit, se nuk munde te hynë ne maredhenje kontraktuale me operator ekonomik te cilët ofertojnë me produktet medicinale të prodhuesve nga Serbia si: "Zdravle Akavis" - Leskovc, "Hemofarmi - Stada" - Vršac dhe "Jugoremida" - Zenjanin. Ndërsa operatori ekonomik ankues (tanime Paditesi) ka ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" - Leskovc.

24. Kundër te njëjtit vendim OE "Exklusiv" Gjilan, ka paraqitur kerkese padi ne Gjykatën Themelore Departamenti per çështje Administrative, me kërkesë për anulimin e vendimit PSH nr. 271/12. 08.10.2012.

25. Gjykata Themelore në Prishtine - Departamenti per çështje Administrative, me Aktgjykimin nr. A.1323/2012 të datës 21.02.2017 ka aprovuar si te bazuar kërkesë padinë e paditësit "Exklusiv" sh.p.k Gjilan dhe e ka kthyer çështjn në rishqyrtim tek e paditura (OSHP), me arsyetim se e paditura nuk ka dorëzuar në gjykatë ofertën e paditësit "Exklusiv" shpk, Gilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Infuzione, me nr prok: 206/12/047/111.

26. Me Vendimin e kundërshtuar PSH. nr. 271/2012 të datës 20.03.2018 Paneli Shqyrtues i Prokurimit, pasi çështja është kthyer në rivendosje sipas Aktgjykimit te Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, A. Nr. 1323/2012, të dt: 21.02.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë me dt.: 20.03.2018, ka refuzuar ankesën e OE "Exklusiv" sh.p.k. me Seli në Gjilan, dhe ka vërtetuar vendimin e OSHP-se, PSH. Nr. 271/12, i dt. 08.10.2012, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë.

Paneli Shqyrtues ka deklaruar se AK- MSH, lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë ka zbatuar vendimin ne fuqi te Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale (AKPM) dhe të MSH-se mbi pezullimin e importit te produkteve medicinale nga\_Serbia, derisa te behet verifikimi i kualitetit te tyre. Po ashtu Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK-MSH, gjate fazës se tenderimit i ka njoftuar te gjithë operoret ekonomik te interesuar te cilet kanë terhequr dosjet e tenderit, se nuk munde te hyjne ne maredhenje kontraktuale me operator ekonomik te cilët ofertojne me produktet medicinale te prodhuesve nga Serbia si: "Zdravle Aktavis" - Leskovc, "Hemofarmi - Stada" - Vrshac dhe "Jugoremida" - Zrenjanin. Ndërsa operatori ekonomik ankues (tanime Paditesi) ka ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" - Leskovc. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se OE ankues nuk ka arritur deshmoj interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit te zbatuar nga autoriteti kontraktues MSH, ne pajtim te nenit 4 par. 1 pika 26 te LPP-se.

27. Lidhur me pretendimin e paditësit *se vendimi i te paditurës se pare PSH.nr. 271/2012, te datës 20.03.2018, është i paligjshëm ngase ai vendim nuk e merr parasysh një veprim dëmtues të paditurës së dyte, e cila me kontrate e ka detyruar paditësin qe te importoj mallra te cilat pastaj i ka përjashtuar nga qarkullimi juridik, gjykata vlerëson të pabazuar me arsyetim se paditësi i referohet Kontratës që ndërlidhet me një aktivitet tjetër të prokurimit me nr. 71300/10/647/111 me titull “Furnizim me barna dhe material shpenzues” ndërmjet MSH dhe Kontraktuesit Exklusiv SH.P.K. sipas kësaj kontrate respektivisht neni 2 thuhet se produktet duhet jenë nga prodhuesi Zdravlje, Actavis, Company- Serbi, konform ofertës financiare të kontraktuesi të datës 20.10.2010 me pamundësi të ndryshimit, kontrata e vlefshme me afat prej 24 muajsh, e cila kontratë e detyron të paditurën në përmbushje e oblogimeve kontraktulë që rrjedhin nga po kjo kontratë por jo në aktivitete të tjera të prokurimit.*

28. Gjkata vlerëson se kriter i eliminimit të paditësit nga aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111 ishte mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, e që sipas njoftimit për kontratës në dosjee e tenderit ne specifikimet teknike, ne seksionin 9.1 kërkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale, pika dy: kërkohet që barnat duhet të kenë Cerfitikatën për Marketing për

Kosovë (5 vjeqare). Është jo kontestuese se paditësi kishtë ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" – Leskovc, për të cilat posedon Cerfitikatën për Marketing për Kosovë me numer MA 0420/151208, të datës 15.12.2008 me afat të vlefshmërisë deri me datë 15.12.2013, por kjo certifikatë është pezulluar nga Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale, përmes e-mailës së datës 19.01.2012 kur paditësi "Excluzive" sh.p.k. ishte njoftuar me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë për pezullim të certifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia. Ndaj këtij vendimi nuk ka asnjë dëshmi që është kontestuar apo është vlerësuar ligjshmëria vendimit të datës 19.01.2012 por paditësi pa e kontestuar vendimin për pezullim të certifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia, e konteston tani vendimin PSH.nr. 271/2012, të datës 20.03.2018 lidhur me aktivitet "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111, me arsyetim se nuk e merr parasysh një veprim dëmtues të paditurës së dytë duke ju referuar Kontratës për aktivitetin e prokurimit me nr. 71300/10/647/111 me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues" ndërmjet MSH dhe Kontraktuesit Exklusiv SH.P.K - e të cilën gjykata e vlerëson se nuk ka të bëjë fare me këtë aktivitet të prokurimit. Gjykata rikujton se paditësin se pretendimet për dëmtim që rrjedhin nga Kontrata për aktivitetin e prokurimit me nr. 71300/10/647/111 me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues" ndërmjet MSH dhe Kontraktuesit Exklusiv SH.P.K. mund ti kontestoj në procedure kontestimore civile por që në këtë rast konstatohet arsye e eliminimit të paditësit nga aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111 ishte mosplotësimi i kriterëve të dosjes se tenderit, sepse Cerfitikata për Marketing për Kosovë me numer MA 0420/151208, të datës 15.12.2008 me të cilën paditësi kishtë ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" – Leskovc, ishte pezulluar sipas vendimit/njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë për pezullim të certifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia.

29. Prandaj, Gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit, vendimi i kundërshtuar është në përputhje me nenin Neni 47 të LPPA-së, sa

i përket strukturës dhe i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar si dhe arsyetimin konform nenit 48 të LPPA-së. Prandaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.58/22, datë 25.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.